

Të mbrojmë mjedisin për të ardhmen tonë dhe vendin ku jetojmë!

Rrethanat dhe mjedisi ndikojnë mbi ne, por ne jemi përgjegjës për vetveten.

Paulo Coelho

*Në këtë buletin do të gjeni:*

**Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit 2024**

**Partneriteti AKM-AEM**

Faqe 1

**Publikime Mjedisore**

**Takimi rajonal “Statusi i laboratorëve mjedisorë në Ballkanin Perëndimor”**

Faqe 3

**Raporti i Gjendjes në Mjedis**

**Trajnime mbi zbatimin e Konventës së Stokholmit**

Faqe 2

**Mbështetje e UNEP MAP /MedPol**

**Takimi i Grupit të Punës të Palëve në Protokollin për Regjistrin e Shkarkimeve dhe Transferimit të Ndotësve**

Faqe 4

**Konferenca Përfundimtare mbi zbatimin e CAMP Otrantos (Coastal Area Management Programme)**

Faqe 5

## Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit, 2024



Bazuar në VKM-në Nr. 1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit”, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka hartuar Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit për vitin 2024.

Ky program është një mjet i vlerësimit të gjëndjes dhe cilësisë së mjedisit në tërësi dhe shërben si bazë për kërkesat e institucioneve monitoruese për të paraqitur projektet, me ofertat e tyre. Institucionet monitoruese kontraktohen nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për monitorimin e treguesve konkrete të dukurive natyrore, të cilësisë së përbërësve të mjedisit si ajri uji, toka dhe biodiversiteti duke përdorur metoda të validuara apo të akredituara.

Të dhënat e monitorimit pas përpunimit, paraqiten në Raportin e Gjendjes së Mjedisit të vitit respektiv. Monitorimi i mjedisit është një sistem, i cili nëpërmjet paraqitjes së treguesve mjedisorë, vlerëson kushtet mjedisore, ndotjen nga aktivitetet e subjekteve operuese si edhe studion tendencat mjedisore. Monitorimi mjedisor, mbështetet në zhvillimin e politikave dhe zbatimin e tyre, sigurimin e informacionit të vazhdueshëm për raportimin tek politikëbërësit kombëtarë, forumet ndërkombëtare dhe publikun.

Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit përfshin treguesit për analizën e mostrave të ajrit, zhurmës, tokës, ujërave sipërfaqësor e nëntokësor, sipërfaqet pyjore dhe biodiversitetin.

Monitorimi mjedisor bazohet në zbatimin e metodologjisë **DSPIR** e cila përbën një rrjet analizash të mundshme për të zhvilluar strategjitë menaxhuese në përputhje me politikat kombëtare dhe ndërkombëtare.

Qëllimi është që të arrihet një përsosje e procesit të monitorimit të mjedisit si dhe për të përmbushur detyrimet kombëtare dhe ndërkombëtare të raportimit për gjendjen e mjedisit.

Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit 2024, është i publikuar në faqen zyrtare të AKM ([www.akm.gov.al](http://www.akm.gov.al)).

## Partneriteti AKM-AEM

Në kuadër të partneritetit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me Agjencinë Europiane të Mjedisit AAEM) si pjesë e Rrjetit Europian të Vëzhgimit dhe Informacionit Mjedisor (EIONET) kanë vijuar aktivitetet sipas Programit Vjetor të Punës me vendet e Ballkanit Perëndimor, të miratuar nga Komisioni Europian. Gjatë takimit vjetor të Pikave Fokale Kombëtare në muajin tetor 2023, në Maltë, u rikonfirmua edhe një herë vijimi i mbështetjes dhe asistencës teknike që do të vijojë të ofrohet nga ekspertët e AEM edhe gjatë periudhës 2023-2024. Fushat ku do të asistohemi në drejtim të rritjes dhe konsolidimit të kapaciteteve teknike të institucioneve shqiptare të përfshira në EIONET janë në përputhje të plotë dhe në linjë me prioritetet e Axhendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor.



Në vitin 2024 do të fillojë implementimi i gjithë aktiviteteve të planifikuara në Planin e Punës për vitin 2024 si vijon:

- ✚ Rritja e kapaciteteve vlerësuese dhe raportuese të biodiversitetit,
- ✚ Përmirësimi i infrastrukturës raportuese të cilësisë së ajrit
- ✚ Rritja e kapaciteteve në kuadër të projektive mjedisore dhe parashikimeve në fushën e mjedisit,
- ✚ Vlerësimi i situatës aktuale kombëtare të gjendjes së tokave dhe ndotjes së tyre në Shqipëri
- ✚ Rritjen dhe forcimin e kapaciteteve sa i takon përmbushjes së detyrimeve raportuese që lidhen me ujërat
- ✚ Corine Land Cover 2024, etj.

Drejtoresha e re ekzekutive e AEM, znj. Leena Ylä-Mononen, rikonfirmoi edhe një herë mbështetjen e saj për vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Shqipërinë.

## Raporti i Gjendjes në Mjedis

Agjencia Kombëtare e Mjedisit është institucioni përgjegjës për hartimin dhe publikimin e Raportit të Gjendjes në Mjedis. Drejtoria e Menaxhimit dhe Edukimit Mjedisor ka si objektiv grumbullimin e të dhënave si dhe përgatitjen e Raportit të Gjendjes në Mjedis.

Në këtë kuadër janë grumbulluar të dhëna nga sektorët e AKM-së dhe nga institucione të ndryshme që disponojnë të dhëna mjedisore. Gjithashtu burim tjetër i rëndësishëm janë institucionet monitoruese të kontraktuara nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit të cilat kryejnë monitorime për komponentë të ndryshëm mjedisorë.

Synimi i monitorimit dhe vlerësimit të gjendjes në mjedis është që të krijojë një panoramë mbi cilësinë e mjedisit si dhe të ndihmojë në marrjen e veprimeve për përmirësimin e gjendjes së mjedisit.

Ruajtja dhe kujdesi për mjedisin nuk është vetëm një detyrim shoqëror, por mbi të gjitha është dhe një përgjegjësi individuale. Duke parë rëndësinë e mjedisit, lind nevoja për mbrojtjen e tij nëpërmjet:

- ✚ Monitorimit të treguesve mjedisorë
- ✚ Vlerësimit të gjendjes së mjedisit dhe rolit të aktivitetit njerëzor
- ✚ Dhënies së rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes së mjedisit
- ✚ Marrjes së masave nga politikëbërësit

Për këtë arsye është përgatitur dhe publikuar Raporti i Gjendjes në Mjedis 2022, i cili nxjerr në pah ndryshime pozitive që janë arritur në komponentët kryesor të mjedisit krahasuar me vitet e mëparshme, problematikat që vazhdojnë të jenë prezente, ndikimin e aktivitetit njerëzor në mjedis si dhe masat që duhet të ndërmerren lidhur me përmirësimin e treguesve të mjedisit.



Raporti i Gjendjes në Mjedis jep një panorama të përgjithshme, për njohjen e publikut me gjendjen e komponentëve të mjedisit si; ujë, tokë, ajër, etj, treguesve të ndikimit dhe presioneve që ushtrohen nga aktivitetet njerëzore apo ato natyrore.

Raportin e Gjendjes në Mjedis 2022, mund ta gjeni në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

<https://akm.gov.al/raporte-dhe-publikime/>

## Trajnime mbi zbatimin e Konventës së Stokholmit

Agjencia Kombëtare e Mjedisit ishte pjesëmarrëse në trajnimin e zhvilluar në kuadër të projektit “Global NIP Update” në datat 17-18 Tetor në Podgoricë Mali i Zi. Trajnimi kishte si qëllim forcimin e zbatimit të Konventës së Stokholmit për Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm edhe në kuadër të projekteve GEF ID të titulluar “Zhvillimi global, rishikimi dhe përditësimi i planeve kombëtare të zbatimit (NIPs) sipas Konventës së Stokholmit (SC) për Ndotësit Organikë të Përherëshëm (POPs)” ose me titull Rishikimi dhe Përditësimi Kombëtar i Plani i Zbatimit për Konventën e Stokholmit për Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm (NOP) në Shqipëri, Armeni dhe Kazakistan.



Ky trajnim rajonal ishte i destinuar për shkëmbimin e përvojës midis shtatë vendeve të projektit për GEF 10785 dhe 10924. Për secilin vend, ishin pjesëmarrës 8 ekspertë/përfaqësues kombëtarë që punonin në inventarin e NOQ-ve të rinj - mbi NOQ-të e brominuara dhe të gjitha pesticidet NOQ.

Duke pasur parasysh sasinë e NOQ-ve të reja, ky trajnim u fokusua kryesisht në NOQ-të që përmbajnë brom (PBDE duke përfshirë deca-BDE, hexabromocyclododecane (HBCDD), HBB), por gjithashtu do të mbulojë pesticidet e listuara rishtazi si heksaklorocikloheksanet (përfshirë lindanin), endosulrophenolt., dikofol dhe metoksiklor).

Ky trajnim pati dhe një fazë të dytë e cila u zhvillua në Republikën Ceke në datat 3-5 Dhjetor. Përgjatë këtij trajnimi:

- U dha informacion mbi karakteristikat dhe përdorimin (përdorimin e mëparshëm) të NOQ-ve të brominuara të listuara dhe pesticidet POP të listuara rishtazi duke përfshirë sektorët ku mund të gjenden kimikate të tilla.
- U treguan detyrimet në lidhje me menaxhimin e NOQ-ve të reja dhe mundësitë për përjashtimet.
- U dha informacion mbi importin, prodhimin i artikujve, përdorimin, trajtimin në fund të jetës së NOQ-ve të sapo listuara dhe artikujve/produkteve të lidhura me to dhe informacion për të identifikuar NOQ-të e mundshme të brominuara ose vendet e kontaminuara me pesticidet të listuara rishtazi.
- Informacion mbi studimet e rasteve nga projektet e mëparshme në rajon për të treguar se si të kryhet

inventarizimi bazë dhe të arrihet nga inventari i nivelit I në inventarin e nivelit III, aty ku është e mundur.

- Gjithashtu fokusi ishte dhe tek shkëmbimi i informacionit midis vendeve pjesëmarrëse për procesin kombëtar të mbledhjes së informacionit duke përfshirë identifikimin e grupeve kryesore të palëve të interesuara dhe bashkëpunimet.



### Publikime Mjedisore

Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka përgatitur dhe publikuar dy dokumente në lidhje me rolin e aktivitetit njerëzor mbi mjedisin si dhe veprimet që duhet të ndërmerren nga komuniteti dhe politikëbërësit për përmirësimin e gjendjes në mjedis.

Ndikimi i njeriut në mjedis (ose ndikimi antropogjen mjedisor) i referohet ndryshimeve në burimet natyrore, ekosistemet, biodiversitetin të shkaktuara drejtpërdrejt ose tërthorazi nga njerëzit. Ndryshimi i mjedisit për t'iu përshtatur nevojave të shoqërisë po shkakton efekte të rënda, duke përfshirë degradim mjedisor, ngrohjen globale, humbja e biodiversitetit etj. Mbishfrytëzimi i burimeve natyrore është një situatë që tejkalon kapacitetin e qëndrueshëm të ekosistemit dhe çon në degradimin e mjedisit dhe humbjen e burimeve jetësore.

Dokumenti “Roli i aktivitetit njerëzor mbi mjedisin” tregon lidhjet shkak-pasojë të veprimit njerëzor dhe natyror në mjedis. Qëllimi kryesor është që të identifikojë disa nga aktivitetet njerëzore dhe të kuptohen pasojat ose ndikimet në mjedis. Të inkurajojë të gjithë komunitetin dhe palët e interesuara në zhvillimin e aktiviteteve miqësore me mjedisin si dhe në ndërmarrjen e veprimeve të duhura në zvogëlimin e ndikimit negativ në mjedis të aktivitetit njerëzor (biznese, individë, komunitete, industri etj) dhe natyror (ngrohja globale, klima, erozioni etj).



Një dokument i rëndësishëm është edhe “Veprimet për përmirësimin e gjendjes mjedisore 2022”, i cili paraqet një përshkrim të shkurtër mbi gjendjen në mjedis për komponentë të ndryshëm si dhe rekomandon veprimet që duhet të ndërmerren për përmirësimin e situatave problematike. Po ashtu thekson dhe adreson çështjet më emergjente mjedisore që kërkojnë masa të menjëhershme për përmirësim.

Çështjet emergjente lidhen me:


Trajtimin e ujërave urbane para se të derdhen në ujërat pritëse, Ndotja nga zhurmat, Ndikimi i faktorëve artificialë në regjimin e ujërave nëntokësore, Shkallë të lartë të rrezikut për përmbytje në disa lumenj referuar matjes së prurjeve, Evidentimi i fenomeneve të erozionit të pranishme në shtratin e lumit Erzen dhe Ishëm, Prania e Kromit (Cr) në thellësinë e tokës 10-15 cm, duke shkaktuar ndotje të vijës bregdetare Kanali i Hoxharës - Porti i Vjetër Vlorë

Këto dokumente mund t'i gjeni në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

<https://akm.gov.al/raporte-dhe-publikime/>

### Takim rajonal “Statusi i laboratorëve mjedisorë në Ballkanin Perëndimor”

Projekti EU4Green organizoi në 6-7 Nëntor 2023 në Tiranë, seminarin rajonal “Statusi i laboratorëve mjedisorë në Ballkanin Perëndimor” ku merrnin pjesë Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Bosnja e Hercegovina, Serbia, Mali i Zi. Në këtë seminar Agjencia Kombëtare e Mjedisit u përfaqësua nga Menaxhere e Cilësisë së Labororit të AKM-së, e cila mbajti dhe prezantimin mbi statusin e aktivitetit laboratorik, sistemin e akreditimit, mangësitë, nevojat, sfidat dhe planet për të ardhmen.



Objektivi i seminarit ishte prezantimi i kapaciteteve dhe pajisjeve të laboratorëve mjedisorë në çdo vend të Ballkanin Perëndimor (WB6) dhe diskutimi i pikave të forta dhe të dobëta të laboratorëve që identifikojnë ndotësit mjedisorë. Objektivi i ditës së dytë ishte shkëmbimi i eksperiencës për statusin e laboratorëve që operojnë në fushën e ndotësve organikë dhe ndotësve inorganik në mostrat e ajrit, mbetjeve, ujit dhe tokës, zbulimi i sinergjive dhe boshllëqeve si dhe

interesat dhe kërkesat e ardhshme. Eksplorimi i mundësive të trajnimit për vitin 2024.

Pjesëmarrësit u ndanë në dy grupe pune për të identifikuar nevojat e tyre se cilat substanca organike dhe inorganike duan të matin në cilat matrica në të ardhmen.

Në sesionin final u prezantua përmbledhje e rezultateve të grupeve të punës dhe u diskutuan mundësitë e trajnimit në lidhje me përgatitjen e mostrës, analizat me metoda dhe pajisje specifike, bashkëpunimet e laboratorëve për trajnime.

**EU4GREEN** Mbështet zbatimin e Axfordës së Gjellbër për vendet e Ballkanit Perëndimor.

### Mbështetje e UNEP MAP /MedPol

Laboratori i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit ishte përfaqësues i Shqipërisë në programin e financuar nga UNEP/MAP në bashkëpunim me Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (International Atomic Energy Agency, IAEA), Monako. Laboratori ishte pjesë e trajnimit dy javor të MED Pol, që u mbajt në 6-17 Nëntor 2023 në ambientet e IAEA në Monako. Trajnimi u organizua për analizat e pesticideve organoklorinike dhe bifenileve të poliklorinuara si dhe mbi teknikat analitike për përcaktimin e elementëve gjurmë në mostrat mjedisore.



Pjesëmarrësit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit ishin Znj Klaudia Çera për metodikat e analizimit të metaleve të rënda në ujërat detarë dhe Znj Irisi Hada për metodikat e analizimit të komponimeve organike në ujërat detarë.

Gjatë këtij trajnimit pjesëmarrësit janë njohur me laboratorin, pajisjet dhe metodikat e analizimit dhe konkretisht:

- Njohja me pajisjet e nevojshme për kryerjen e procedurës së mostrimit si dhe trajnimi në terren për marrjen e mostrave, si për metalet e rënda ashtu dhe për komponimet organike.
- Janë mësuar procedura dhe teknika peshimi, acidifikimi, analizimi për komponimet kimike, si dhe është kryer procesi i diseksionit në biotë.
- Njohja me software të ndryshme që përdoren në pajisje për analizim dhe nxjerrje të dhënash.
- Përveç anës praktike, pjesëmarrësit janë trajnuar edhe për pjesën teorike ku kanë marrë njohuri për procedurat e validimit të të dhënave.

### Takimi i Grupit të Punës të Palëve në Protokollin për Regjistrin e Shkarkimeve dhe Transferimit të Ndotësve


Takimi i dhjetë i Grupit të Punës të Palëve në Protokollin për Regjistrin e Shkarkimeve dhe Transferimit të Ndotësve (PRTR), (WGP10) u zhvillua në Gjenevë më 27-28 nëntor 2023 (Palais des Nations), Shqipëria u përfaqësua nga pika fokale (NFP) Znj. Enkeleda Shkurta, Përgjegjëse e Sektorit të Informacionit, GIS dhe Regjistrave Mjedisore në Drejtorinë e Regjistrave Mjedisore, Inovacionit dhe Analizave Laboratorike në AKM si dhe nga drejtori i kësaj drejtorie Z. Neritan Postoli. Agjencia Kombëtare e Mjedisit është përgjegjëse për krijimin dhe menaxhimin e Regjistrit të Shkarkimeve dhe të Transferimit të Ndotësve në vendin tonë. Këtë vit për shkak se Kryetari i Byrosë së Protokollit nuk mund të merrte pjesë për arsye shëndetësore, ky takim u drejtua nga Pika fokale e Shqipërisë, si nënkryetare e Byrosë së Protokollit.



Grupi Punues, shqyrtoi progresin në zbatimin e programit aktual të punës dhe një sërë pikash, duke përfshirë çështjet financiare; promovimi dhe koordinimi; mekanizmat e raportimit dhe pajtueshmërisë; dhe aktivitetet nënrajonale dhe kombëtare. Palët, shtetet e tjera anëtare të interesuara dhe palët e interesuara ndanë përvojat e tyre në zbatimin e regjistrave të çlirimit dhe transferimit të ndotësve dhe diskutuan praktikën e mira, sfidat dhe tendencat kryesore. Grupi punues shqyrtoi edhe përgatitjet për seancën e pestë të Takimit të Palëve dhe mori një sërë vendimesh në këtë drejtim.



## Konferenca Përfundimtare mbi zbatimin e CAMP Otrantos (Coastal Area Management Programme)



Konferenca përfundimtare e projektit ndërkufitar “CAMP Otranto” u mbajt me 13 Dhjetor 2023 në Tiranë. Tema ishte Horizontet Ndërkufitare: Rritja e Qëndrueshmërisë Bregdetare në Adriatikun e Jugut.

Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të projektit, përfaqësues nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit si dhe nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Fjalimet përshëndetëse u pasuan nga diskutime në panel për të dhënë një gamë të gjerë opinionesh mbi rezultatet e projektit. Marrëveshja ndërkufitare e ngushticës së Otrantos mund të jetë pioniere. Kjo do të forconte bashkëpunimin rajonal për të mbrojtur mjedisin brenda sistemit të Konventës së Barcelonës. Diskutimet përfshinin sfida mjedisore si turizmi, përmytjet, ngritja e nivelit të detit, mbetjet dhe masat e duhura të nevojshme.



Znj. Klodiana Marika përfaqësuese e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit theksoi se ky projekt ishte një pikënisje për të mbrojtur biodiversitetin përtej ujërave kombëtare.

Në lidhje me ndikimin e bashkëpunimit ndërkufitar në rajon, në një tryezë të rrumbullakët u diskutua se si përvoja e bashkëpunimit ndërkufitar ka kontribuar në zonat e mbrojtura detare dhe zbatimin e ICZM.



Përfaqësuesi i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në Shqipëri, Z. Sofjan Jaupaj theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërkufitar sepse mund të mësojmë nga vendet e tjera. “Tani kemi një bazë të mirë për mbledhjen e të dhënave dhe krijimin e parashikimeve për të adresuar nevojat tona. Shpresoj që ky bashkëpunim të vazhdojë.”

Znj. Tatjana Hema, koordinatoreja e UNEP/MAP shtoi se si i gjithë sistemi MAP kontribuon në projektet CAMP me përvoja të ndryshme. Ajo shpjegoi se: “Bashkëpunimi i mirë në nivel kombëtar dhe ndërsektorial është çelësi për përmirësimin e cilësisë së mjedisit detar për njerëzit që jetojnë

në zonat bregdetare – kjo është vlera më e rëndësishme e projektit CAMP.

Gjatë takimit, të pranishmëve iu treguan videot e projektit të animuar, infografikë dhe materiale komunikimi që theksonin mjetet e projektit dhe rëndësinë e menaxhimit të integruar ndërkufitar të zonës bregdetare, e cila tregon historinë e lidhur me detin mes Italisë dhe Shqipërisë.

